

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 21 KORRIK 2022

E nderuara Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është shumë e qartë për të gjithë që ky Kuvend e ka demonstruar së fundi, nëpërmjet sjelljes së kësaj shumice, se atë që quhet funksion i kontrollit, ai funksioni jetik dhe i natyrshëm i Kuvendit, nuk është funksion i kësaj maxhorance. Ju e kuptoni më së miri, edhe qytetarët e kuptojnë, kur shikojnë që pesë institucionet e pavarura, në seancën e fundit të këtij sesi, ashtu, në tufë të gjitha së bashku, bëjnë sikur bëjnë raportimin e radhës. Shumica dërmuese e tyre, mbase 95%, janë zgjedhur nga shumica, janë kanakarët e shumicës, të paprekurit e saj, dhe çdo sugjerim apo vërejtje për ta, sigurisht, ka paternalizmin shumë bajat të shumicës, duke rrënuar një element thelbësor, atë që këta institucione kanë, se janë institucione të pavarura.

Pra, u janë besuar fusha të mëdha të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, ku kanë pavarësinë, se Kushtetuta dhe ligji ua ka dhënë, dhe më mirë se çdokush tjetër janë ata që u qëndrojnë këtyre problemeve te koka, janë njëllor korrektë, qoftë ndaj çdo ekzagjerimi, arrogance që maxhoranca mund të ketë, apo çdolloj pretendimi të tepruar që mund të ketë opozita, pra janë të pavarur. Por ndodh e kundërta, çdolloj vërejtje për funksionimin e tyre, e thashë edhe një herë, ka dashuri të pafund të shumicës dhe nuk bën as më shumë e as më pak, i asfikson këto institucione, i bën thuajse të pavlera, pa influencë dhe në shumë raste, në vend që të jenë ato që ngrenë zërin, që ngrenë problemet, që venë “me shpatulla pas muri”, në mënyrë të veçantë qeverisjen, se ajo i ka atributet për të zgjidhur gjërat, përkundrazi shëmtueshëm konformohen dhe në fund, qytetarët që presin t’i kenë si pika referimi, nuk mund t’i kenë si të tilla.

Në traditën e hershme të këtij Kuvendi, kush ka memorie në këtë sallë, 25 – 30 vjet përpara, kishte një përgjegjshmëri shumë më të lartë nga ky institucion, jo bajat dhe i bastarduar si tani, zhvillohej një seancë e vetme, ku një institucion i pavarur raportonte, kishte një debat të gjatë për të gjitha çështjet, sepse ishte më shumë se qeveri, më shumë se ministër drejtuesi i atij

institucioni, në atë fushë veprimtarie dhe në fund të debateve mbeteshin shumë gjëra të rëndësishme në mendje, shumë gjëra viheshin në lëvizje, vëmendja e publikut tërhiqej, institucionet bëheshin gjithnjë e më të njohura dhe më familjare. Ndërsa, më ndjeni, këta janë si një paradë e ditës, 1, 2, 3, 4, 5, papritmas na thanë në seancë se njeri nuk është, iku, por nuk ka gjë, se e bëjmë në shtator, ndonëse ka një detyrim që të gjitha duhet të mbyllen në qershor, sipas Rregullores së Kuvendit (kjo e shkretë Rregullore është bërë si llastiku i atyre), praktikisht demonstroi qartazi se ky parlament nuk ka më asnjë atribut, ka hequr dorë nga atributi i kontrollit.

Ne asistua një javë më parë, ku drejtuesit e institucioneve, për turpin e kësaj shumice, arritën të mos i pranoni as në sallë. Nderi më i madh që na u bë si deputetë, si monitorues e kontrollues, ne që do të miratojmë rezolutën, ishte kur erdhën disa këshilltarë, bedelë të tyre, se institucionet nuk patën kohë të humbnin me deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo është situata e vërtetë. Një parlament që heq dorë nga funksionet e tij të kontrollimit, të monitorimit, të vigjilimit mbi këto institucione, do të thotë që republika parlamentare bie. Bie për arsyen e thjeshtë, se maxhoranca ka zgjedhur t'i zgjedhë vetë, t'i ketë gojëmbyllurit e saj, e thashë edhe një herë, i ka kanakarët e saj, në mënyrë që ata të mos e shqetësojnë, të mos e mërzhisin.

Këtu u pretendua, me të drejtë, që Avokati i Popullit, në shumë raste, ka mjaft rekomandime të rëndësishme, që nuk i dëgjon njeri, por nuk ka se si të dëgjojnë. Këta i kanë thënë: mos pyesni fare, sepse ato institucione i kanë zgjedhur ata të opozitës, varjani atyre, le të thonë çfarë të duan, punë e madhe. Kjo është. Ne deputetëve këtu në sallë, që duam të informohemi për Avokatin e Popullit, nuk na kthejnë përgjigje. Bëjmë letra ne Kuvendit, por ata nuk na kthejnë përgjigje, drejtoruca, sekretaruca të Përgjithshëm e të gjithë, nuk e informojnë Kuvendin, se nuk janë kanakarët e qeverisë. Nuk ka gjë, mos u ktheni përgjigje, punë opozite. Po çfarë standardi është ky? Ky është standard idiot, që kur të zbresësh nga pushteti të mos ta vërshëllesh ty.

Po kush dëmtohet? Dëmtohet e mira publike, se kjo republikë është krijuar mbi balancën e kontrollit. Nëse e humb këtë cilësi kontrolli ky parlament, atëherë nuk i duhet as drejtit dhe kushdo që rri e tund mandatin e deputetit, tund hiç gjënë nga ky krah, por edhe nga tjetri, se

këta nuk dëgjohej, ndërsa këtyre të tjerëve nuk ua vërshëllen njeri, se kur i vë Kryeministri ata janë të atij dhe nuk pyesin, po e patën mirë me atë, ia varin këtyre të tjerëve, kush i llogaritë, se do ta ngrenë dorën këta si të gjithë të tjerët. Kjo është situata. Sa i takon raportimit të Avokatit të Popullit, patjetër do të kishte qenë seanca më e rëndësishme jona, një ditë e tërë do t'ia vlente, nuk ia vlente të ndanim kohën me sekonda dhe me minuta, ku mesatarja për të diskutuar për një fushë veprimtarie të madhe, po marrim Avokatin e Popullit, që kemi temë diskutimi, është 90 minuta, për 140 deputetë, ku secili është sovran në mandatin e tij, mesatarisht i bie të ketë 40 sekonda secili.

Në çdo seancë të zakonshme, edhe ku ndryshojmë një germë të një ligji, kemi të drejtë 10 minuta të flasim, kurse këtu 140 deputetë kanë 40 sekonda. E përse ndodh kjo? Sepse nuk duan ta ushtrojnë funksionin e kontrollit. E shikojmë me zili parlamentin e 25 vjet më përpara, se ishte shumë më dinjitoz, sepse në atë batërdis që është bërë mbi liritë dhe të drejtat e njeriut sot, nuk do të mjaftonte nata, do të ishte për t'u gdhirë, do të ishte një ballafaqim i madh. Çdo liri dhe e drejtë e shprehjes, e pronës, e manifestimit publik, të drejtat minimale bazike që ndërtonim nga një rend, të pretenduar shumë nga kjo shumicë, kur ishte në opozitë, duke rrëmbyer foltoret, të gjitha gjërat i ka bërë, shumë mirë ka bërë, se në të drejtë të saj ka qenë, sot janë herezi.

Këto liri dhe të drejta janë kaq të shkelura dhe të nëpërkëmbura, dhe Avokati i Popullit, që është institucioni i natyrshëm kushtetues, me të cilin do të kishim mundësi t'i diskutonim, katandisemi, që nga 1 orë e gjysmë, të kontrollohemi në mënyrë shumë fiskale që sekondat të mos kalojnë dhe në fund të kryejmë dhe të bëjmë në mënyrë të shëmtuar adetin e radhës. Ndaj, u bëj thirrje kryetarëve të grupeve parlamentare që të rishikojmë mënyrën se si raportojnë institucionet e pavarura. Një turp i tillë, ku parada e dhjetëra institucioneve kaluan sot në një ditë, nuk duhet të përsëritet më kurrë në parlamentin shqiptar.